



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPËSTINA VUÇITRN

02 Nr. / Br 891/22

Nr. i fq. / Br. st _____

Data: / Datum 06.07.2022

VUSHTRRI - VUÇITRN



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 67, “f” dhe “g” të Statutit të Komunës, si dhe në bazë të propozimit të Drejtorisë për Ekonomi bujqësi pylltari dhe zhvillim rural dt. 04.07.2022, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M
PËR FORMIM TË KOMISIONIT PËR MBIKËQYRJE TË FUSHATËS SË KORRJE-SHIRJEVE

1. Me këtë vendim formohet komisioni për përcjellje të fushatës së korrje-shirjeve në këtë përbërje:
 - 1.1 **Avdyl Feka**, kryesues (për EBPZHR)
 - 1.2 **Selim Pllana**, anëtar (DEBPZHR)
 - 1.3 **Bajram Beqiri**, anëtar (DMSH)
 - 1.4 **Zymer Idrizi**, anëtar
 - 1.5 **Sabri Dallku**, anëtar (DSHP)
2. Komisioni në përbërje të cekur në pikën paraprake të këtij vendimi do të përcjell përkatësisht monitoroj mbarëvajtjen e fushatës së korrje shirjeve në territorin e komunës së Vushtrrisë si dhe të hartoj raport me shkrim për Kryetarin e Komunës lidhur me përfundimin e fushatës si dhe rendimentet e arritura nga korrje shirjet.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Vendimi i dërgohet:

- Drejtorit për Ekonomi Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural,
- Anëtarëve të komisionit dhe
- Arkivit të Sekretarisë.

Ferit Idrizi

Kryetar i Komunës



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPŠTINA VUÇITRIN

02 Nr. / Nr. 898/22

Nr. i Sq. / Dr. st.

Qarku: / Datum: 08.07.2022

VUSHTRRI - VUÇITRIN



REPUBLICA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 67 Shkronja "f" dhe "g" të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M
PËR FORMIM TË KËSHILLIT ORGANIZATIV

1. Formohet Këshilli Organizativ për organizimin e manifestimit "Ditët e Diasporës", në këtë përbërje:
 - 1.1 Fazli Muharremi - Përgjegjës i teatrit, kryesues i KO
 - 1.2 Driton Vërbovci - Përgjegjës i ansamblit AKV "Hasan Prishtina"
 - 1.3 Gëzim Saraçi - Përgjegjës i Q.K. Hasan Prishtina
 - 1.4 Shukrane Begu - Përgjegjëse e Muzeut
 - 1.5 Lidije Pasoma – Bibliotekiste
 - 1.6 Driton Haliti - Zyrtar në AKV "Hasan Prishtina"
 - 1.7 Ferki Rama - Zyrtar në Drejtorinë e Prokurimit
 - 1.8 Besim Demiraj - Zyrtar në Drejtorinë e Buxhetit
 - 1.9 Albiona Isa – Kabineti i kryetarit
2. Drejtoresha e Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport do të ndihmoj në punët që do ti kryej Këshilli Organizativ si dhe do të raportoj në mënyrë të rregullt te Kryetari i Komunës lidhur me përgatitjet organizimin dhe mbarëvajtjen e shënimit të këtij manifestimi.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Ferit Idrizi

Kryetari i Komunës



Vendimi iu dërgohet:

- Drejtoreshës së DKRS
- Anëtarëve të Këshillit Organizativ
- Arkivit të Sekretarisë.

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRIË - OPŠTINA VUÇITRRI

UZ Nr. / Nr. 932 / 22

No. llog. / Br. sh.

Data: / Datum 15.07.2022

VUSHTRRI - VUÇITRRI



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari



Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 67, "g" të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

1. Nga buxheti i komunës – subvencione dhe transfere, lejohet subvencionimi i nxënësve të komunës së Vushtrrisë të arsimit për të rritur (sistemi për të rritur 3-6 muaj), të cilët i përfundojnë me sukses mësimet për aftësim profesional në Diakonie Training Center në Mitrovicë si dhe në qendra tjera të akredituara të arsimit profesional në Kosovë, deri në çmimet e poshtëshënuara për kurse trajnimi si në vijim:
 - 1.1 Rrobaqepësi, pagesa 225.00 € për person
 - 1.2 Parukeri, pagesa 400,00 € për person
 - 1.3 Qeramikë punues, pagesa 70.00 € për person
 - 1.4 Instalues i ngrohjes qendrore, pagesa 135 € për person
 - 1.5 Instalues i ujësjellësit dhe kanalizimit, pagesa 135 € për person
 - 1.6 Instalues elektrik, pagesa 135 € për person
 - 1.7 Knauf, Fasadë dhe Ngjyrosje, pagesa 135 € për person
 - 1.8 Make up/grim, pagesa 380 € për person
 - 1.9 Konstruksione Druri (mobiliери), pagesa 135 € për person
 - 1.10 Berber, pagesa 240 € për person
2. Pagesa sipas pikës një (1) të këtij vendimi bëhet për persona që janë banorë rezident të Komunës së Vushtrrisë të cilët me certifikatë e dëshmojnë kryerjen e trajnimit nga data 01 janar 2022 deri më 31.12.2023.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Ky vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.




Ferit Idrizi

Kryetar i Komunës

Vendimi iu dërgohet:

- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
- Arkivit të Sekretarisë



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 67 “g” të Statutit të Komunës, dhe nenin 7 të Rregullores (KKV) nr. 04/20, prot. nr. 95/20, datë 28.05.2020 për Ndarjen e Bursave për Studentë Nxënës dhe Shpërblimeve për Nxënës, me propozim të Drejtorisë për Arsim 10Nr.715/22, dt. 18.07.2022, Kryetari i Komunës me datën 20 korrik 2022 merr këtë:

V E N D I M

- Me këtë vendim caktohet numri i bursave sipas drejtimeve të studimeve si dhe shuma financiare prej 400.00 € për një bursë, që do të ndahen për 22 student të rregullt të Komunës së Vushtrrisë, për vitin akademik 2021/22, si vijon:

1.1 Fakulteti Filozofik	2
1.2 Fakulteti i Edukimit (programi parafillor)	2
1.3 Fakulteti Filologjik	2
1.4 Fakulteti Juridik	2
1.5 Fakulteti Ekonomik	2
1.6 Fakulteti i Mjekësisë	10
1.7 Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë	1
1.8 Fakulteti i Edukimit Sportiv	1
- Zbatimin e këtij vendimi do t’ a bëj Drejtoria për Arsim, konform Rregullores në fuqi për Ndarjen e Bursave për Studentë Nxënës dhe Shpërblimeve për Nxënës të Komunës së Vushtrrisë.
- Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.




Ferit Idrizi

Ferit Idrizi
Kryetar i Komunës

Vendimi i dërgohet:

- Drejtorisë për Arsim
- Arkivit të Sekretarisë



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Në pajtim me nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr. 03/L-040 dhe nenin 44 pika 3 të Ligjit për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera nr. 04/L-027, nenin 5 paragr. 1 pika 1.2 të Ligjit për Mbrojtje nga Zjarri Nr. 04/L-012, nenin 67 “f” dhe “g” të Statutit të komunës, pas gjendjes së krijuar në terren me rastin e zjarreve të shkaktuara në ditët e fundit në disa pjesë të territorit të Komunës së Vushtrrisë si dhe me propozim të Drejtorisë për Mbrojtje dhe shpëtim dt. 22.07.2022, Kryetari i Komunës merr këtë:

VENDIM
PËR THEMELIMIN E SHTABIT PËR GATISHMËRI EMERGJENTE NË KOMUNËN E
VUSHTRRISË

1. Me qëllim të ndërmarrjes së masave për tejkalim të gjendjes së krijuar në terren nga zjarret e shkaktuara si pasojë e temperaturave të larta dhe nga veprimet e disa keqbërësve, formohet Shtabi Komunal për Gatishmëri Emergjente në këtë përbërje:

1. **Maliq Ferizi**, Drejtor i DMSH-së, kryesues,
2. **Bajram Beqiri**, zyrtar në DMSH, anëtar,
3. **Benjamin Shala**, Drejtor i DSHP, anëtar
4. **Nexhmedin Rashica**, Drejtor i DSHS, anëtar,
5. **Fadil Hyseni**, Shef i Nësisë së Zjarrfikësve
6. **Reshat Kovaçi**, Komandant i Stacionit Policor, anëtar
7. **Përfaqësuesi i KEDS- it**, anëtar
8. **Shefqet Maloku**, Udhëheqës i njësisë KRU në Vushtrri, anëtar
9. **Bekim Selmani**, Udhëheqës i zyrës së gjendjes civile, anëtar
10. **Fadil Bahtiri**, Kryeshef i NLP “Përparimi”, anëtar
11. **Safet Ahmeti**, Ud.i drejtorit të KRM “UNITETI”, njësia Vushtrri, anëtar
12. **Gëzim Saraçi**, zyra për informim, anëtar.

1. Të gjitha këshillat e fshtrove, shndërrohen në nënshtabe emergjente (si pasojë e gjendjes aktuale me zjarre në komunën e Vushtrrisë), për gatishmëri emergjente, të cilat marrin udhëzime nga shtabi komunal pas gjendjes së krijuar nga zjarret.
2. Bazuar në Planin Komunal për Mbrojtje nga Zjarri Shtabi emergjent duhet të përcjellë 24 orë situatën në terren, dhe koordinoj punët dhe veprimet e tij përmes zyrës komunale për lajmërim, të bashkëpunoj me Policinë e Kosovës, KEDS-in, Ujësjellësin Rajonal “Mitrovica”, Njësia në Vushtrri akter tjerë relevant të ndërlidhur në këto situata emergjente, me qëllim të mbrojtjes së popullatës dhe të mirave materiale nga zjarri.

3. Drejtorët përkatës të drejtorive komunale duhet të ofrojnë mbështetjen e duhur për Qendrën apo ekipet në terren gjatë gjithë kohës sa zgjat gjendja e emergjente si dhe të i kenë në dispozicion në çdo moment të hapur telefonat mobil.
4. Zyra për informim të komunës të përcjell situatën në terren dhe sipas nevojës informoj me kohë qytetarët lidhur me gjendjen në terren për të përballuar sa më lehtë dhe pa pasoja situatat emergjente.
5. Vendimi hyn në fuqi menjëherë.



Ferit Idrizi

Ferit Idrizi

Kryetar i Komunës



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPŠTINA VUÇITRN

02 Nr. / Br 1000/22

Nr. i fig. / Br. st _____

Data: / Datum 29.07.2022

VUSHTRRI - VUÇITRN



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28/2008) dhe nenit 67 “g” të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës jep këtë:

URDHËRESË

1. Drejtoria për Inspektime në bashkëpunim me Policinë të ndërmerr masa për respektim të sinjalistikës dhe kufizimit të lëvizjes së mjeteve me veprim motorik duke përfshirë edhe biçikletat në bulevardin “Adem Jashari” në Vushtri duke përfshirë masat e shqiptimit të gjobave konform legjislacionit të zbatueshëm, për shkelësit e kësaj urdhërese.
2. Banuesve në ndërtesat e banimit në shesh iu lejohe qasja me mjete me veprim motorik vetëm me leje të organit kompetent të komunës.
3. Për pronarë të lokaleve afariste në të dy anët e sheshit lejohe furnizimi me mall – qasje me automjete me veprim motorik çdo ditë nga ora 05,00-08,00 e mëngjesit. Pronarët e këtyre lokaleve duhet të pajisen me leje të posaçme nga organi kompetent i komunës për qasje në shesh për furnizim me mall.
4. Përjashtim nga kjo urdhëresë bëjnë, zyrtar të organeve të rendit dhe sigurisë, njësitit i zjarrfikësve në raste emergjente dhe ato të ndihmës së shpejtë si dhe kompania e mbledhjes së mbeturinave, kur qasja në shesh është e domosdoshme
5. Urdhëresa hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet në faqen zyrtare të komunës.



Ferit Idrizi

Kryetar i Komunës

Urdhëresa i dërgohet:

- Drejtorisë për Shërbime Publike,
- Drejtorisë për Inspektime,
- Zyrtarit për Informim
- Arkivit të Sekretarisë